



GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2024:015246
Datë: 28.03.2024
Numri i dokumentit: 05515873
C.nr.524/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Dega në Viti, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Alush Sinani, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Ajeti, në çështjen juridike kontestimore paditëses B.M., nga fshati S., Komuna e V., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson G.R., avokat nga V., kundër të paditurës Komuna e V. - Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensim i pagave shtesë i të ardhurave personale mbi bazen e kualifikimit, me vlerë prej 963€, jashtë seancës gjyqësore, me datë 18.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Apropohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses B.M., nga fshati S., Komuna e V., detyrohet e paditura Komuna e V., që paditëses në emër të pjesës së paguar të pagave për punonjësen me kualifikim shkollor grada - Master, për periudhën kohore 01.10.2021 deri më 31.03.2022, t'ia paguaj shumën prej 963€, duke llogaritur shumën prej 160.65€ për 6 muaj, me kamatë ligjore prej 8 % duke llogaritur nga data e paraqitjes së padisë, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

II. Detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 125 Euro, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të daj më datë 10.01.2024 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës me objekt kontesti kompensim i pagave shtesë i të ardhurave personale për licencim, me vlerë të kontestit 963€.

Në padi, ka theksuar se paditësja është mësimdhënëse në Gjimnazin "Kuvendi i Lezhes", në Viti, në cilësinë e mësimdhënëses, ndërsa përkundër obligimit që i rrjedhë të paditurës nga Ligji i Punës, Kontrata Kolektive e Arsimit dhe Vendimi i Qeverisë, paditësja nuk është kompensuar sipas kualifikimit të saj shkollor –fakultet. Lidhur me këtë ka theksuar se i është drejtuar me kërkesë të paditurës, por e paditura ka refuzuar kërkesë e tyre. Duke marrë për bazë se paditëses sipas 35 % të pagës bazë është dashur të paguhet në shumën sipas kualifikimit të saj, ka shtuar se e paditura duhet t'ia kompensojë pjesën tjetër të pakompensuar, ashtu që për periudhat kohore gjatë kohës sa ka qenë në fuqi kontrata kolektive, gjykatës i kanë propozuar t'ia aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e tyre dhe të detyrojë të paditurën në kompensimin e shumave si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Padisë i ka mbështetur këto prova: Kërkesa drejtuar të paditurës bashkë me dëftesën postale; Vërtetimi i përvojës së punës ; Diploma Master; Kompja e listes së pagave; Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura në përgjigje në padi ka theksuar se e kundërshton në tërësi të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke theksuar se nuk gjen mbështetje ligjore, pasi beneficionet e parapara nga Kontrata Kolektive e Arsimit të Kosovës duhet të paguhen nga niveli qendror – Ministria e Administratës Publike; Ministria e Financave dhe Ministra e Arsimit. Për më tepër ka theksuar se Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit e kanë shkëputur këtë kontratë, prandaj i njëjti nuk mund të prodhojë obligim ligjor te e paditura. Ka theksuar se paditësja ka nënshkruar kontratën e saj të punës sipas kualifikimit mësimdhënës, pra kualifikimi ka qenë kriter për themelimin e marrëdhënies së punës dhe të ardhurat personale i realizon sipas kësaj pozite, ashtu që në arsimin fillor paguhet prej 58.00 €, në arsimin e mesëm prej 68.00 €, ndërsa në master prej 80.00 €. Gjykatës i ka propozuar të refuzojë të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), pasi gjeti se kërkesëpadia e paditësës është e themeltë dhe mes palëve nuk është kontestuese gjendja faktike.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura dhe ka vijuar mësimin gjatë periudhës së kërkuar për kompensim në emër të kualifikimit. Nuk është kontestuese se paditësja është mësimdhënëse e kualifikuar fakultet të licencuar (fakt i vërtetuar edhe nga diploma nr.1185 e dt.04.12.2018 dhe se e njëjta për kualifikim paguhet në shumën prej 160.65€). Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit merititor, pasi themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008.

Në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri më datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe bashkëpunorëve profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me nje ngritje te pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%. Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë, rastet e kualifikimit-licencimit është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Në rastin konkret, gjykata vlerësoi se e paditura nuk ia ka kompensuar paditësës pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor, përkatësisht me kualifikim master e njëjta duhet të paguhet për 35 % të pagës bazë (421€), me ç'rast i ka mbetur borxh paditësës në shumën prej 160.65 €.

Nga kjo arsye, detyroi të paditurën t'ia kompensojë shumën e përcaktuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në emër të kompensimit të kualifikimit shkollor – përkatësisht diferencën e papaguar për muajt e punës sa i përket periudhës të llogaritur për 1 vite para ushtrimit të padisë, në përputhje me nenin 87 të Ligjit të Punës.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës me përgjigje në padi lidhur me faktin e zbatimit ose jo të kontratës kolektive, gjykata i gjeti të pabazuara, pasi në rastin konkret baza juridike e kërkesës së paditësës

Numri i lëndës:

2024:015246

Datë:

28.03.2024

Numri i dokumentit:

05515873

buron nga Vendimi i Qeverisë. Edhe pretendimin se paditësja sipas këtij kualifikimi është pranuar në punë dhe në kontratat e tyre të punës përcaktohen përqindjet sipas kualifikimit, gjykata e gjeti fakt jo relevant për këtë çështje kontestuese, pasi përqindjet sipas kriterëve të licencimit të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë dhe në kontratë të punës kanë dallim mes vete dhe mësimdhënësit nuk kompensohen sipas këtyre kriterëve.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452.1 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104€ dhe taksës gjyqësore në shumën prej 31€, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 135€.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Dega në Viti-Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.524/2024, datë 18.03.2024

Gjyqtari,
Alush Sinani

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit, përmes këtij Gjykate.